



Albania
Investment
Council





Improving Transparency and Investment Climate

SFIDAT E NVM-ve – TRANZICIONI DREJT BURIMEVE ALTERNATIVE TË ENERGJISË




Mbledhje e Këshillit të Investimeve,
31 Janar 2023

PËRMBAJTJA

- 1  Objekti dhe metodologjia
- 2  Konteksti
- 3  Gjetje kryesore
- 4  Rekomandime

OBJEKTI



Stimulimi dialogut mbi sfidat e NMV-ve në lidhje me investimet në burime alternative të energjisë, në fokus:

a) Cilësia e furnizimit me energji dhe faktorët që influencojnë vendimmarrjen mbi investimet

b) Niveli i informimit mbi aksesin në financë.



Prioritizimi i ndërhyrjeve për adresimin e pasigurive të sipërmarrësve në kuadër të dinamikave të tregut të energjisë dhe Axhendës së Gjelbër.

Desk-research

- **Raporte kombëtare dhe ndërkombëtare**, ligje/akte nënligjore, strategji
- **Analiza të të dhënave** zyrtare
- **Sinteza** e gjetjeve dhe rekomandimeve të deritanishme
- **Puna e deritanishme e Sekretariatit** mbi problematikat në tregun e energjisë

Konsultime

- **4 fokus grup** me shoqata të biznesit dhe dhoma të tregtisë, ekspertë, institucione të përzgjedhura në nivel teknik dhe politik, OJQ, partnerë për zhvillim, akademi, etj (47 pjesëmarrës)
- **Takime rajonale** me 10 biznese individuale në Tiranë, Vlorë dhe Korçë, Durrës

Pyetësorë

- **Intervista të strukturuar** me fokus sfidat (kosto dhe cilësisë së investimeve në energji (23 përgjigje)
- **Pyetësor për kompanitë** eksplorimi i njohurive të biznesit mbi mundësitë drejt investimit në energji dhe njohja e tyre me burimet e financimit (75 përgjigje)
- Sektori i Turizmit dhe Industria Përpunuese

PROGRES RAPORTI I BE-SË PËR SHQIPËRINË (2022)

Ka përparime në kuadrin ligjor për efikasitetin e energjisë, por **ende duhen miratuar** aktet që mungojnë.

Për sa i përket energjisë së rinovueshme, **Shqipëria ka miratuar** ndryshimet në ligjin e vitit 2017 në janar 2021, por **ende nuk është ngritur** agjencia përgjegjëse për energjinë e rinovueshme.

IRENA 2021

Krijimi i sigurisë energjetike, qëndrueshmëria e sektorit energjetik dhe një furnizim i garantuar me çmime konkurruese janë disa nga **sfidat kryesore** që vendi duhet të adresojë në afatshkurtër.

Sfidat **përmbushen** duke rritur më tej pjesën e **energjisë së rinovueshme në sektorin** e energjisë elektrike të vendit në mënyrë të **diversifikuar**.

UNECE (2021), EBRD (2022)

UNECE (2021): Shqipëria një nga vendet e para në Evropën Juglindore që prezantoi ankandet për projektet e energjisë së rinovueshme dhe që atëherë ka tenderuar me sukses projekte FV me çmime konkurruese.
EBRD (2022): Shqipëria e para në rajon që adoptoi kuadrin që parashikon stimulimin e burimeve johidro të rinovueshme dhe masat për efikasitetin e energjisë për uljen e gazrave greenhouse.

Raporte Kombëtare

ERP i referohet objektivave të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës për rritjen e sasisë së **energjisë së rinovueshme në konsumin final me 59.4% krahasuar me 54.4%.**
BIDS 2022-2027 nuk përmban përfaqësim sektorial, por thekson se prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme **duhet të konsiderohet avantazh strategjik** për vendin.

Rëndësia

Furnizimi me energji elektrike në Shqipëri është pothuajse **tërësisht i varur nga hidrocentralet, 98% e prodhimit të energjisë elektrike vjen nga hidrocentralet, tërësisht të varur nga kushtet e motit dhe nga regjimi hidrik i lumenjve dhe burimeve.**

Luhatja e madhe e prodhimit të hidrocentraleve çon vazhdimisht në nevojën për import të energjisë elektrike **duke e bërë Shqipërinë një importuese neto të energjisë.**

Tregu

Energjia elektrike në Shqipëri prodhohet nga **Korporata Publike e Prodhimit**, si dhe nga subjekte të tjera si **prodhuesit prioritarë, prodhuesit e pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike.**

Tregu i energjisë elektrike **karakterizohet aktualisht vetëm nga kontrata bilaterale**, lidhura ndërmjet shoqërive që operojnë në tregun shqiptar të energjisë elektrike. **Themelimi i tregut të organizuar (Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX) është në procedurat finale.**

Kontributi

Në 2020 kontributi i sektorit të energjisë në ekonomi ishte 2,37% e PBB.

Referuar Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Energjisë 2030, **kërkesa vjetore për energji në Shqipëri pritet të rritet me 77% në vitin 2030** krahasuar me nivelet e vitit 2018.

Sektori i transportit parashikohet të jetë konsumatori më i madh i energjisë, i ndjekur nga ai rezidencial, industrial dhe ai i shërbimeve.


Rritja më e lartë e kërkesës për energji do të vërehet në sektorin e shërbimeve.

EKOSISTEMI INSTITUCIONAL



- SIPËRMARRJA MBI SIGURINË E FURNIZIMIT ME ENERGJI

Sa ndikon në biznesin tuaj
ndërprerja e energjisë elektrike?




A keni pasur ndërprerje të energjisë
elektrike, mesatarisht në muaj?



- SIPËRMARRJA MBI SIGURINE E FURNIZIMIT ME ENERGJI


A e keni menduar opsionin e investimit në burime alternative të prodhimit të energjisë, panele diellore, era, biomasa etj?



Sektori privat është i vetëdijshëm për burime të tjera alternative të prodhimit të energjisë

- 9 nga 10 kompani kanë informacion për burime alternative
- 22% e tyre kanë investuar edhe pse me mendime të ndryshme për efektivitetin e tyre.


A e keni menduar opsionin e investimit në fushën e efijencës së energjisë?



Efijenca e energjisë, si një formë e uljes së koston së energjisë, njihet mirë nga bizneset (95%)

- 1 në 5 kompani ka bërë disa investime në këtë drejtim

Cili nga faktorët do të ndikontë më shumë në vendimin tuaj për të investuar në efijencën e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?




Vendimi i një kompanie për të investuar në efijencën e energjisë dhe/ose burime alternative të energjisë ndikohet kryesisht nga:

- aftësia për të ulur koston e energjisë
- furnizimi i sigurt me energji

– SIPËRMARRJA MBI BURIMET E FINANCIIMIT


Sa të familjarizuar jeni mbi format e financimit të investimit në fushën e efijencës së energjisë dhe /ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë



Ka mungesë informacioni për mundësitë alternative për investime në energjinë e rinovueshme

- 62% e kompanive të intervistuar deklarojnë se nuk kanë ose kanë pak informacion

Me kë jeni më të familjarizuar mbi format e financimit të investimit në fushën e efijencës së energjisë dhe/ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë



Bankat perceptohen si kanali investues më i njohur i përdorur nga sektori privat për të financuar investimet e tyre në efijencën e energjisë dhe/ose burime alternative të prodhimit të energjisë

- 38% e kompanive deklarojnë se njohin bankat si burim kryesor financimi
- Nga takimet u konstatua se Procredit Bank kishte një linjë krediti shumë fleksibël dhe të mirëndërtuar në këtë drejtim.

Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe futja e tyre në tregun e energjisë **ka patur një fokus të shtuar në vitet e fundit në Shqipëri**

Kapaciteti i lejuar aktualisht deri në 500 kw për instalimin e njësive gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike nga era ose dielli nga një shoqëri e vogël ose e mesme apo një klient familjar, **nga më të lartat në rajon (ku varion zakonisht deri në 200 kw)**

Zhvillimi i BRE, në këtë rast i kapaciteteve të gjeneruara nga vetëprodhuesit duhet të konsiderojë:

- **kapacitetet e kufizuara** të rrjetit të shpërndarjes,
- **domosdoshmërinë e tij për investimeve** (të kufizuara në vitet e fundit nga krizat e njëpasnjëshme)
- **sforcimin buxhetor** për stabilizim të cmimit për konsumatorët

Evidentohen një sërë dinamikash dhe iniciativash në fushën e optimizimit të konsumit, projekte në:

- **Mbështetjen dhe incentimin e familjevë** të cilat instalojnë panele diellore (70% grant për koston e investimit)
- **Kursim të energjisë nga institucionet publike** (vendosja e administratorëve të energjisë)
- **Nxitjen e efiçenës në ndërtesa**
- **AZHBR (2018-2022), 24 projekte (5,94 milion grant)**

Projektligji i ri për nxitjen e burimeve të rinovueshme (tashmë në procedurat parlamentare) **pritet të sjellë një incentivim** të ri në lidhje me BRE



NDËRGJEGJËSIMI I NVM-ve MBI BURIMET E PËRFITIMIT TË ENERGJISË

Ka ndërgjegjësim në lidhje me burimet alternative të prodhimit të energjisë dhe efijencës në energji

Pasiguritë mbi uljen ose jo të kostove dhe furnizim i sigurt me energji, faktorë përcaktues në vendimmarrje për investime

- AXHENDA E GJELBËR DHE EFIÇENCA E ENERGIJISË SI PRIORITET




ASPEKTE LIGJORE & RREGULLATORE

- Ka progress por **ende ka nevojë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator** (primar& sekondar) që optimizon investimet ne energjitë e rinovueshme (p.sh. *skema e netimit, përcaktimi i çmimit të surplus, etj.*);
- **Mungesa e legjislacionit dytësor** që mbështet ndërtimin e parqeve me **erë** për qëllime vetëkonsumi;
- **Mospërputhjeje** ndërmjet dispozitave ligjore që lidhen me fuqinë maksimale të instaluar në dispozicion të vetëprodhues (unifikimi deri ne 1MW);
- **Pamundësia për të tregtuar “çertifikatat e gjelbra” dhe “garancitë e origjinës** në një treg rajonal pengon që procedurat e burimeve te rinovueshme të kenë akses në burime financiare shtesë;
- **Mungesa e koncepteve të “Agreguesit” dhe “Komunitetit të Energjive të Rinovueshme”**. Aktualisht, energjia elektrike që prodhohet nga vetëprodhuesit, shkëmbehet vetëm me Furnizuesin e Shërbimit Universal

- AGJENDA E GJELBËR DHE EFIÇENCA E ENERGIJISË SI PRIORITET

ASPEKTE TEKNIKE



- **Garantimi i parametrave të cilësisë së furnizimit** me energji sipas standardeve, **evitimi i ndërprerjeve të shpeshta të furnizimit** dhe i **luhatjeve të tensionit** të rrjetit mbi normat teknike të lejuara, mbetet ende një sfidë;
- **Detyrimi aktual për vendndodhjen e detyrueshme** të njësisë gjeneruese të energjisë elektrike në të njëjtin ambjent me njësinë konsumuese të energjisë elektrike, kufizon investimet në fotovoltaikë;
- Pavarësisht specifikimit ligjor lidhur me reduktimin në sasi dhe në kohë piku të konsumit të energjisë elektrike, **ERE ka miratuar tarifa vetëm për dekurajimin e konsumit të energjisë elektrike në kohë piku**, por a mundet të konsiderohet incentive edhe për konsumin e energjisë elektrike në orët e natës/fashat me konsum të ulët.

- AGJENDA E GJELBËR DHE EFIÇENCA E ENERGJISË NË QENDËR TË PRIORITEVE TË KOMPANIVE DHE QEVERISË

ASPEKTE TË KONKURRUESHMËRISË

Trajtimi me çmime/njësi të energjisë elektrike të diferencuara për të njëjtën kategori biznesesh.



ASPEKTE EKONOMIKE - FINANCIARE

Mbështetja e projekteve në sektorin e energjisë elektrike, nëpërmjet mbështetjes buxhetore, aktualisht **kufizohet vetëm në segmentin e konsumatorëve familjarë.**

GJETJE

- QASJA NË FINANCIM PËR INVESTIME NË INSTRUMENTE TË ENERGJISË

NDËRGJEGJËSIM I SEKTORIT PRIVAT MBI MUNDËSITË EKZISTUESE TË FINANCIMIT DHE AKTORËT E PËRFSHIRË

- Ka **mungesë informacioni** për mundësitë alternative për investime në energjinë e rinovueshme dhe, kostimin dhe kohën e kthimit të investimit, duke theksuar nevojën për më shumë fushata informuese;
- **Bankat perceptohen si kanali investues më i njohur** i përdorur nga sektori privat për të financuar investimet e tyre në efikasitetin e energjisë dhe/ose burime alternative të prodhimit të energjisë;
- Ekziston **një ndërgjegjësim i limituar i aktorëve kryesorë** duke përfshirë institucionet, bizneset, bankat, etj. në lidhje me mekanizmat administrativë dhe financiarë që inkurajojnë ose lehtësojnë investimet në fushën e prodhimit të energjisë së rinovueshme.



REKOMANDIME

– NË NIVEL MAKRO DHE POLITIK

MFE/MIE të ndërmarrin një vlerësim të instrumenteve aktuale në dispozicion të NVM-ve, veçanërisht për ato që operojnë në sektorë kryesorë – me objektiv transparencë ndaj këshillimit dhe informimit, mbështetje financiare, mbështetjen e auditimeve të energjisë dhe zbatimin e rekomandimeve të audituesve mbi efikasitetin e energjisë.

Zhvillimi i një instrumenti të centralizuar (p.sh. platformë, agjenci, faqe interneti, aplikacion, etj.), si qendër informacioni që përfshin dhe transmeton edhe praktikën më të mirë të menaxhuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

MIE/ERE të mundësojnë zbatimin praktik të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017, lidhur me konsultimin e planit të investimit të OST dhe OSSH me palët e interesuara përpara paraqitjes për miratim në ERE. **Shoqatat e Biznesit të jenë aktive në procese të konsultimit.**

REKOMANDIME

– NË NIVEL LIGJOR DHE RREGULLATOR

PËRMIRËSIMI I LEGJISLACIONIT PRIMAR

- Skema e matjes neto të energjisë elektrike mbi bazë vjetore
- Rritja e kapacitetit të instaluar nga vetëprodhuesit në 1 MW
- Adoptimi i koncepteve të “Agreguesit” dhe “Komunitetit të Energjive të Rinovueshme”
- Mundësia e instalimit të njësisë prodhuese, në një vend tjetër nga ai i konsumit
- Krijimi i instrumentit/institucionit koordinues të BRE

ORGANIZIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR

- Miratimi i procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për energjisë elektrike nga era
- Miratimi i Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal
- Lehtësimi i procedurave administrative për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese që nuk janë objekt konçensioni (deri në 50 në miratim nga MIE/MBI 50 Më miratim nga KM)

ZBATIMI NË NIVEL RREGULLATOR

- Krijimi i tregut/miratimi i procedurave për tregtimin e “certifikatave të gjelbra” dhe “garancive të origjinës”
- Miratimi dhe bërja transparente e “Treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes”
- Përcaktimi i kompensimit në rastet e mosrespektimit të standardeve të mësipërme
- Përcaktimi tarifave të veçanta incentivuese për energjinë elektrike të konsumuar në orët e natës/fashat me konsum të ulët

REKOMANDIME

- NXITJA E SEKTORIT PRIVAT DREJT INVESTIMEVE NË BURIME ALTERNATIVE TË ENERGJISE

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë/Shoqatat e Biznesit në bashkëpunim me universitetet dhe qendrat e specializuara të njohurive, duhet të angazhohen në mënyrë proaktive në projekte, evente dhe sesione trajnimi që mundësojnë rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit (në fokus NVM-të) për të zgjeruar njohuritë e tyre dhe të përmirësojnë kapacitetet e tyre menaxhuese mbi energjinë.

Bankat, promovuesit e skemave mbështetëse dhe institucionet e tjera financiare që japin kredi, duhet të kenë më shumë në fokus promovimin e produkteve inovative në energji dhe forcimin të kapaciteteve të stafit të tyre në nivel lokal.

DISKUTIME

Siguria e Furnizimit me energji

Një rrjet i qëndrueshëm i furnizimit me energji është i domosdoshëm dhe ndikon drejtpërdrejt në mirëfunksionimin e aktivitetit të biznesit. Në kornizën e krizave aktuale të energjisë dhe varësisë së Shqipërisë nga një regjim hidro-energjitik i paqëndrueshëm për shkak të ndryshimeve intensive të klimës, *çfarë mund të bëhet për të adresuar paqartësitë e ngritura të sigurisë në furnizimin me energji?*



Rritje të ndërgjegjësimit/Mentorimit

Kapacitetet lokale të krijimit/menaxhimit të njohurive të NVM-ve për diversifikimin e energjisë dhe instrumentet mbështetëse të vazhdueshme (vendore dhe ndërkombëtare) mund të zbusin kostot fillestare të investimeve në lidhje me investimet në energjinë e rinovueshme, veçanërisht NVM-të në sektorët prioritarë, si turizmi dhe industria përpunuese. *Kush mund të promovojë dhe lehtësojë procesin?*



Potenciali

Shqipëria mund të jetë një “bateri e gjelbër” për rajonin e Ballkanit për shkak të potencialit të saj të jashtëzakonshëm në burimet e rinovueshme, por sektori privat vendas mbetet i shqetësuar për efikasitetin e këtyre “burimeve të reja të energjisë” dhe ende heziton të investojë në këtë drejtim. *Egzistenca e planeve të qarta për tregun e energjisë?*



Agjenda e Gjelbër dhe modele green (ESG), Nevoja për rimodelimin e biznesit

Qëndrueshmëria e biznesit bazuar në trinomin MJEDISI – SOCIAL – EKONOMIA



FALEMINDERIT!

www.investment.com.al